



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 165, datë 06.04.2023**

**PËR**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT TË GJYKATËS SË  
RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 132, datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër", Vendimit të KLGJ-së nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, Vendimit nr. 42, datë 30.03.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,:

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me përbërje:
  - Z. {...}– Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
  - Zj. {...}– Antar (Zv.Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër);
  - Zj. {...}– Antar (Zv.Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet);
  - Zj. {...}- Antar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër);
  - Zj. {...}- Antar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet).
2. Komisioni i Ristrukturimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i cili ushtron funksionet, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**